




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës  
Opstina Kamenica  
Kamenica Municipality



## PROCESVERBAL

### Nga mbledhja e VII-të e Komitetit për Komunitete e mbajtur më: 26.08.2022

Mbledhja u mbajt në objektin e komunës e cila filloj ora 10:10. Në mbledhje përveç anëtarëve të komitetit, morën pjesë edhe Shefi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Shërbimi profesional i kuvendit, përkthyesi, përfaqësues të OSBE-së dhe të OJQ-v. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Komitetit për Komunitete Dejan Vasić i cili për mbledhje propozoi këtë:

#### Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,
2. Raporti i punës i ZKKK-së dhe
3. Të ndryshme

**Dejan Vasić-Kryesues i komitetit për komunitete**, në këtë mbledhje kemi tri pika të rendit të ditës, a keni diçka të shtoni, nëse jo e hedhim në votim.

**Kush është për miratimin e rendit të ditës?**

**Për u deklaruan të gjithë**

#### 1. Miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar

**Dejan Vasić-Kryesues i komitetit për komunitete**, a keni ndonjë vërejte apo diskutim rreth procesverbalit, nëse nuk keni kush është që kjo pikë të miratohet?

**Për u deklaruan të gjithë.**

#### 2. Raporti i punës së ZKKK-së

**Dejan Bllagojević Shefi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim**, në kohën prej gjashtë muajsh zyra jonë ka qenë e angazhuar me aktivitetet e veta, kemi prezentuar në të gjitha mbledhjet që i përket komitetit, kemi pasur takime me IOM-in dhe BE-në, rreth ndërtimit të shtëpive kështu që me pas mundësi që edhe komuna me u inkorporuar në projektin që së paku të ngriten edhe 30 ose 40 shtëpi për të kthyerit. Për ngritjen e bizneseve kemi përfituar tri projekte gjithashtu me IOM-in kemi përfituar që të ndërtojmë rrugën në Berivojcë dhe që ka një vlerë prej 32 mijë euro, prej kësaj vlere 22 mijë ka participuar IOM-i, dhe komuna me 10 mijë euro po ashtu kodi i zyrës komunale për komunitete dhe kemi dhënë ndihma momentale për familjet që janë të rrezikuara ekonomikisht në numër prej 29 sosh. Vlora për familjet që kanë qenë të rrezikuara, kemi dhënë mjete prej 100-500 euro duke e shikuar se si kanë qenë rastet. Jo që e kemi harruar por nuk kemi mujt me shty në raport asfaltimin e rrugës prej

Stralicës deri në Moqar të Poshtëm në gjatësi prej 460 m, po ashtu ky projekt është investuar nga zyra komunale për komunitete prej kodit për investime kapitale. Në vërejtje e kam potencuar në urdhëresën e qeverisë së Kosovës, 2/2010, zyra komunale për komunitete duhet të inkorporohet në kuadër të komunës mirëpo kjo nuk ka ndodhur nga viti 2010 ne me këtë ju kemi drejtuar edhe kryetarit të komunës që do të besoj që do të na dalin në takim.

**Vjosa Emini- Përfaqësues nga OSBE-ja,** familjet që kanë përfituar projekte për gjenerim të ardhurave çfarë nacionaliteti janë?

**Dejan Bllagojević Shefi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim,** 7590€ janë vlera e ndihmave momentale dhe kryesish ka të bëjë me komunitetet jo shumicë.

**Naim Arifi-**rruga tek Romët a mbulohet e tërë pjesa me asfaltim apo vetëm një pjesë e rrugës?

**Dejan Bllagojević Shefi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim,** të gjitha rrugët prej ku fillon restoranti "Joni Ranch", deri te ura e parë e financon Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, kurse nga ura e parë e deri tek kthesa ne kemi aplikuar tek Ministria për Komunitete dhe Kthim në mënyrë që të kryhet gjithë ai rreth.

**Naim Arifi-** A ka kthyer përgjegjje ministria apo jo?

**Dejan Bllagojević Shefi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim,** kemi marrë përgjigje se sigurisht do të realizohet ky projekt dhe sipas projektit kjo rrugë kushton diku 52 mijë euro dhe gjerësia e rrugës do të jetë 6 m.

### 3. Të ndryshme

**Dejan Vasić-Kryesues i komitetit për komunitete,** jemi tek pika në të ndryshme, nëse dikush ka diçka të diskutojë nëse jo e shpallim të mbyllur takimin e sotëm.

Takimi mbyllet në ora 10:20.

Procesmbajtës



Sabile Arifi

